

BULETINI INFORMATIV

GUSHT

2025



Vendimmarrjet e Bordit të ERE gjatë muajit gusht

Gjatë muajit gusht 2025, Bordi i ERE zhvilloi 3 mbledhje vendimmarrëse, ku u shqyrtuan dhe miratuan 21 vendime në funksion të zhvillimit dhe rregullimit së tregut të energjisë.

Licencime të reja

Bordi i ERE-s ka vendosur:

-Miratimin e kërkesës së “POWER ENERGY” sh.p.k. dhe “Energovia.Albania” sh.p.k. për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar secila;

-Licensimin me kusht të shoqërisë “KËLCYRA 2020” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë”, me kapacitet 2 MW, për një afat 30-vjeçar.

-Licensimin e shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet 25 MW, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Bashkia Fier, për një afat 30-vjeçar.

Këto impiante, përkatësisht HEC “Klisyrë” nga “KËLCYRA 2020” sh.p.k. dhe centrali fotovoltai me kapacitet 25 MW nga “POWER ENERGY” sh.p.k. **pritet të hyjnë në operim jo më vonë se data 31.12.2025.**

Gjatë muajit gusht ka vijuar procesi i konsultim publik lidhur me dokumentin **“Udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”** në kuadër të transpozimit të legjislacionit të Komunitetit të Energjisë, për të cilin kanë filluar procedurat me vendimin nr. 150, datë 08.07.2025, të Bordit të ERE.



www.ere.gov.al



+355 45 620 820

+355 45 620 821

Autorizime

Bordi i ERE-s miratoi kërkesat në lidhje me marrjen e autorizimit për vendosjen e kuotave si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj të tretëve për shoqëritë:

“REBESOL” sh.p.k. licencuar me vendimin e Bordit nr. 15, Datë 16.01.2025 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 30-vjeçar.

“SAMASOL” sh.p.k. licencuar me vendimin e Bordit nr. 14, Datë 16.01.2025 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 30-vjeçar.

“SPV Blue 2” sh.p.k. licencuar me vendimin e Bordit nr. 296, Datë 30.12.2024 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 50 MW, për një afat 25-vjeçar.

“RENEW” sh.p.k. licencuar me vendimin e Bordit nr. 68, Datë 08.04.2025 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 30-vjeçar.

ERE po ashtu është shprehur për kërkesën e shoqërisë **“SPV Blue 2” sh.p.k.** licencuar me vendimin e Bordit nr. 296, Datë 30.12.2024 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 50 MW, për një afat 25-vjeçar, për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës sigurorese) e asetëve fikse të shoqërisë, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve.

Me vendimin nr. 193 datë 12.08.2025, u përcaktuan **modalitetet e trajtimit e kërkesave të të licencuarve që aplikojnë për autorizim për transferim asetesh** në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror për të gjithë aplikuesit që kanë plotësuar që në fazën e parë, të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja e procedurave të transferimit të asetëve nga të licensuarit”, duke sjellë nëpërmjet këtij vendimi, **shkurtrimin e afateteve** për trajtimin e këtyre kërkesave.

BULETINI INFORMATIV

GUSHT

2025



Procedura licensimi të filluara gjatë muajit gusht

Gjatë muajit gusht, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) filloi procedurat për licencimin e shoqërive:

-“**AMEL ENERGY**” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

-“**Infotelecom-Albsolar 4**” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga një central fotovoltaike me kapacitet 35.6 MW, i planifikuar të ndërtohet në Gjoricën e Poshtme, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, ERE për të gjitha këto aplikime ka publikuar në median e shkruar, në faqen zyrtare www.ere.gov.al si dhe në rrjetet sociale Instagram, Facebook dhe LinkedIn njoftimin për marrjen e objeksioneve para vendimmarrjes respektive të licencimit ose jo.

Gjatë muajit gusht është përditësuar web i ERE dhe rrjetet social me [vendime](#), [konsultime](#), të dhëna [tregu](#), njoftime të [mbledhjeve](#), njoftime mbi [aplikime të reja për licencim](#) si dhe [Çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për vitin 2025](#).

Gjithashtu, në wefaqen e ERE-s do të gjeni të rifreskuar regjistrat e mëposhtëm:

-Kërkesa dhe përgjigje në Programin e Transparencës ([kliko këtu](#))

-Ankesa të konsumatorit ([kliko këtu](#))

-Licencime ([kliko këtu](#))

-Autorizime ([kliko këtu](#))

Vendime për çmimet dhe tarifat

Në mbledhjen e datës 12 gusht 2025, Bordi i ERE miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2025, në vlerën **16.06 lekë/kWh**.

Ky çmim është më i lartë krahasuar me muajin qershor 2025, i cili ishte **13.97 lekë/kWh**.

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) është variabël dhe ndryshon nga muaji në muaj vetëm prej ndikimit që ka kosto e blerjes së energjisë në tregun e lirë për qëllime të furnizimit të klientëve që furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, pasi kostot e rrjetit dhe kostot administrative mbeten të pandryshuara. Çmimet e energjisë elektrike në tregun e lirë të cilat kryesisht ndikohen prej ndryshimit të kërkesës dhe ofertës së energjisë elektrike në treg e cila në periudhën e verës impaktohet kryesisht prej kushteve atmosferike dhe stinore ku kërkesa për energji rritet (p.sh. përdorimi i kondicionerëve) duke sjellë si rrjedhojë dhe rritje të çmimeve në bursat e energjisë. Konkretisht kosto e blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës për klientët që furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit për muajin korrik ka rezultuar **12.23 lekë/kWh** kundrejt **10.20 lekë/kWh** (qershor) dhe sasia e energjisë së nominuar në bursën e energjisë për këtë qëllim, ka qënë **147.77 MWh** (korrik) kundrejt **109.61 MWh** (qershor). Krahasimisht kosto e blerjes së energjisë elektrike për muajin korrik nga ajo e muajit qershor është rritur me 19.9% ndërkohë që sasia e energjisë së prokuruar për mbulimin e nevojës për furnizim për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët janë shërbyer nga FMF është rritur me 34.8%.

Sa i takon klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kv të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, çmimi i shitjes së energjisë mbetet ai i miratuar nga ERE në fillim të vitit 2025 prej 18.26 lekë/kWh. Ky çmim mbetet i pandryshuar për arsye se kosto e blerjes së energjisë për mbulimin e nevojës për furnizim është fikse dhe ofrohet nga KESH sh.a.

ERE miraton dhe publikon çmimin e llogaritur, për të garantuar transparencë ndaj palëve të interes në zbatim të legjislacionit në fuqi

BULETINI INFORMATIV

GUSHT

2025

Çmimet e shitjes së energjisë për tensionin 20 kV

Furnizuesi	Çmimi (lek/kWh)
NOA HOLDING	16.79
Alb Energy Trade	16.9
Dragobia Energy SHPK	18
ALBESP TRADING & CONSULTING	18
GSA SHPK	18.3
FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË	18.34

Çmimet e shitjes së energjisë për tensionin 35 kV

Furnizuesi	Çmimi (lek/kWh)
NOA HOLDING	13
FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË	15.9
ALBESP TRADING & CONSULTING	16
Alb Energy Trade	16.9

Çmimet e shitjes së energjisë për tensionin 10 kV

Furnizuesi	Çmimi (lek/kWh)
ALBESP TRADING & CONSULTING	18
GSA SHPK	18.3
FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË	18.34

Platforma e krahasimit të çmimeve ([kliko këtu për të aksesuar](#))

Deri në fund të muajit gusht 2025, në platformën e krahasimit të çmimeve janë publikuar oferta nga disa kompani furnizuese që ofrojnë energji elektrike në tregun e lirë. Kompanitë kanë treguar interes të lartë, duke vendosur oferta me çmime dhe afate të ndryshme vlefshmërie. Këto oferta janë të ndara sipas niveleve të tensionit të energjisë (10 kV, 20 kV dhe 35 kV).

Platforma u shërben konsumatorëve si një mjet i thjeshtë dhe i qartë për të krahasuar çmimet dhe kushtet e ofruara, duke u dhënë mundësinë të zgjedhin ofertën më të përshtatshme për nevojat e tyre.

Ofertat në fuqi për sigurimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike në treg të lirë sipas niveleve të tensionit janë të paraqitura në sipër.

Regjistri REMIT

Në përputhje me “Rregulloren për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 126, datë 17.05.2021 si dhe Ligjin nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE ka publikuar të dhënat mbi regjistrimin e Pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike që hyjnë në transaksione me shumicë në Shqipëri (regjistri REMIT). Ky regjistër, gjendet i publikuar dhe i përditësuar në faqen e ERE-s në linkun <https://ere.gov.al/sq/tregu-i-energji-se/remit>. Gjatë kësaj periudhe kohore janë regjistruar tre shoqëri.

Mbi vlerësimin e Raportit Vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë së shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH) për vitin 2024

Referuar Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të jetë i ndarë dhe i pavarur nga aktivitetet e tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike, si dhe të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar. Për këtë qëllim me vendimin nr. 114, datë 27.03.2023, Bordi i ERE-ska emëruar **Zyrtarin e Pajtueshmërisë së OSSH sh.a.**, funksioni ligjor i të cilit është të raportoje në lidhje me përmbushjen e detyrimeve për raportim mbi ndarjen funksionale dhe organizative të operatorit.

Në mbledhjen e datës 07.08.2025, ERE ka vlerësuar **Raportin Vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë së shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH) për vitin 2024, si dhe ka dhënë rekomandimet për vitin 2025.**

Nga analiza e raportit u konstatua se **janë përmbushur detyrimet ligjore dhe institucionale** për publikimin e raportit në gjuhën shqipe dhe angleze në faqen zyrtare: është zbatuar një metodologji e strukturuar për mbledhjen dhe analizimin e informacionit, përfshirë monitorimin e vendimmarrjes, kontratave, ankesave dhe të dhënave të brendshme; është siguruar ndarja funksionale nga strukturat vertikalisht të integruara dhe është përforcuar pavarësia operacionale përmes organigramës së re dhe vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës; janë përmbushur kërkesat për transparencë përmes përmirësimit të komunikimit publik, identitetit vizual dhe ofrimit të shërbimeve më të shpejta dhe inovative, si dhe përmirësimit të informacionit mbi performancën dhe investimet.

Në kuadër të gjetjeve në këtë raport, ERE ka dhënë disa **rekomandime për Zyrtarin e Pajtueshmërisë** në funksion të përmirësimit të zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë të cilat konsistojnë kryesisht në, fokusimin në çështjet kyçe të Programit të Pajtueshmërisë; monitorimin e procesit të transferimit të punonjësve; ruajtjen e pavarësisë dhe integritetit në ushtrimin e funksionit; monitorimin e planit të investimeve dhe zhvillimit të rrjetit; monitorimin i projekteve për matësa dhe matësa inteligjentë; monitorimin i procedurave të ndërrimit të furnizuesit; raportimin mbi Kodin e ri të Shpërndarjes; monitorimin e platformës për menaxhimin e furnizuesve; monitorimin e përmbushjes së detyrimeve për sigurinë kibernetike si dhe raportimin mbi burimet vetëprodhuese dhe gjeneruese.

Garanci Origjine

Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave. Gjatë muajit gusht u miratua kërkesa e shoqërisë KESH sh.a. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës si dhe kërkesa e e kësaj shoqërie për regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për për HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës. Kjo llogari bën të mundur aksesin për të përfutur dhe tregtuar elektronikisht garancitë e origjinës.